



SKANERI I PËRPARUAR I APLIKACIONIT TVSH-JA IME ËSHTË NË DISPOZICION NË VERSIONIN E PËRDITËSUAR NË APPLE APPSTORE DHE HUAWEI APP GALLERY, PO PRITET LEJIM EDHE PËR PLAYSTORE NË GOOGLE

Drejtoria e të Ardhurave Publike, i informon shfrytëzuesit e aplikacionit TVSH-ja Ime, se mund të kthehen në skanerin e përparuar të skanimi të llogarive fiskale. Versioni i adaptuar i TVSH-ja Ime tani më është në dispozicion në [Apple appstore](#), ndërsa për versionin Android është në dispozicion në [Huawei app Gallery](#) ndërsa për Playstore pritet që në kohë sa më të shpejtë të lejohet nga ana e Google.

Shfrytëzuesit e aplikacionit TVSH-ja Ime do të duhet së pari të bëjnë përditësimin (**update**) të aplikacionit të [apple Appstore/Huawei gallery](#), ndërsa më pas të kyçen në aplikacionin në pjesën “Profil”, në dritaren “Lloji i skanerit të barkodit” në vend të “themelor” përsëri të përzgjedhin “i përparuar”.

TVSH-JA IME është masë për qytetarët dhe mjetet nga kjo masë kthehen tek qytetarët. DAP, tash më filloi me pagesën e mjeteve për shfrytëzuesit të cilët kanë skanuar llogaritë fiskale në tremujorshin e dytë, gjegjësisht në muajt prill, maj, qershor të vitit 2022, dhe në bazë të llogarive do të paguhet 550 milion denarë, si kthim nga TVSH-ja Ime.